

VENDIM
Nr. 15, datë 27.1.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s; në mbledhjen e tij të datës 27.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 82/3 prot., datë 26.1.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Balkan Energy Trade’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 341, datë 21.12.2022 ka vendosur të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 23.12.2022 dhe 24.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 1.1.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 2015/3 prot., datë 30.12.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 82 prot., datë 11.1.2023, nr. 82/1 prot., datë 20.1.2023, dhe 82/3 prot., datë 25.1.2023.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c” dhe pikën 2.5.

- Nga vlerësimi i këtij aplikimi rezulton se nuk është depozituar ende vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmia e penaltetit) për administratorin e shoqërisë, por është dokumentuar aplikimi përkatës për marrjen e këtij vërtetimi.

- Duke qenë se ky vërtetimi lëshohet nga një organ tjetër dhe në zbatim të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet të pezullohet vendimmarrja e Bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike deri në 10 (dhjetë) ditë-punë nga marrja dijani e vendimit.

- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimarrjen Bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike deri në 10 (dhjetë) ditë-punë nga marrja dijeni e vendimit.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti